



MINISTRIA E EKONOMISE, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE
SHKODËR

Nr. 106/1 prot.

Shkodër më 18.03.2024

SHPALLJE PËR KONKURRIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.581, date 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, në Urdhrit e Kryeministrit nr.139, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Statutit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër;

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër shpall konkursin për pozicionin vakant:

Punëtor mirëmbajtje në sektorin Kukës – Kategoria e pagës – klasa III.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për këtë pozicion:

1. Kryerja e punimeve të ndryshme në funksion të mirëmbajtjes të pasurive kulturore të DRTK Shkodër .
2. Raporton tek eprori mbi mbarëvajtjen e punës.

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E POSAÇME

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
6. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
7. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidati duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të ketë arsim 8- vjeçar/ 9 vjeçar ose të mesëm;
2. Të ketë të paktën 1-2 vite përvojë pune si punëtor, mirëmbajtje, në ndërtim, mjeshtër i punimeve në dru ose gur, etj;
3. Të ketë aftësi menaxhuese, organizative, komunikuese si dhe punë në grup shumë të mira.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim (CV);

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

- Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf pranë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër brenda datës 01.04.2024.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në DRTK Shkodër , brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.04.2024, DRTK Shkodër do të shpallë në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Komisioni. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen përmes postës elektronike të institucionit individualisht, për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të testimit nga Komisioni sipas një sistemi pikëzimi.

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

Kandidatët do të testohen dhe vlerësohen nga Komisioni pranë DRTK Shkodër sipas pikëzimit:

- a) 40 (dyzet) pikë për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për përvojën profesionale të mëparshme;
- c) 10 (dhjetë) pikë për motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për pozicionin e punës;

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, DRTK Shkodër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtkshkoder.com.

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409